

Mësuesi

Gazi I degës së brendshme gulçonte tek merrte maloren e fortë të Qafës së Hanit. Rruga e re, që kishte shumë kohë që ishte ndërtuar dhe që lidhte zonën e largët malore me qendrën e rrethit, ende nuk ishte stabilizuar, dhe herë bllokohej nga shirat e shumtë e borërat e mëdha që binin.

Në këto raste, banorët e zonës, përdornin rrugët e vjetra këmbësore, që, edhe pse i përshkonin në këmbë, i çonin më përpara në qytet për t'u lidhur me njerëzit e të afërmit e për të mbaruar hallet e tyre.

Por moti i keq nuk kishte filluar akoma, megjithëse sa më shumë i ngjiteshin malit, ata që ishin brenda në "gaz" ndjenin që temperatura binte ndjeshëm.

-Rrugë e vështirë, -tha shoferi, një burrë që nuk rrinte dot pa folur e që për çudinë e të tjerëve, deri atë çast nuk kishte hapur gojën aq nuk duronte dot pa folur ai burrë, sa që njerëzit thoshnin se po të bënte ndonjë krim, të mos e fusnin në burg, por t'i prisnin llafet se kështu do vdiste vetë.

-Zonë e vështirë dhe njerëz të vështirë, -tha kryetari i degës, një burrë i gjatë rreth dy metra e me trup të lidhur...Edhe pse flokëbardhë jo nga moshja shumë e madhe, por si duket nga soji. Ai nuk kishte hequr dorë nga huqet e rinisë. Në bulevardin e vetëm të qytetit, ai i ekspozonte sa herë që kalonte, edhe forcën, edhe pushtetin, edhe cilësitë fizike të tij.

Qeshte fort bënte shaka me zë të lartë me të folurin e tij tiranase dhe ata, që e shoqëronin, gajaseshin, jo nga kripa e shakave, por nga servilizmi. Kishte ardhur si dorë e fortë në këtë rreth e për të thureshin legjenda për trimëritë e mëdha që kishte bërë në kapjen e diversantëve e të bandave dhe në zbulimin e grupeve armiqësore.

Zajdini, se kështu e quanin, erdhi e bë shumë shpejt figura kryesore dhe rreth tij mblidheshin të gjitha: zgjuarsia, trimëria, burrëria, por edhe kurvëria. Ndërsa të parat, njerëzit i deklaroronin hapur, këtë të fundit as nuk e përshpërisnin se..ç'u duhej....Vetëm Beronja e ca të tjera, ia njihnin mirë këtë virtyt, që në fakt zinte vendin e parë në cilësitë e tij. "Beronja" i flisnin në qytet, jo pse e quanin, por se, megjithëse ishte martuar disa vjet, nuk lindte fëmijë edhe pse kishte një trup për t'ia patur zili.

-Më mirë që nuk lind, -thoshnin gojët e këqia, -se do të kishte mbushur dynjanë...

Si një pus i thellë duket këtej, -tha kryehetuesi për zonën, ndërsa makina kishte dalë në grykën e borës. Ditën nga kjo pikë, krahina dukej në pëllëmbë të dorës. Me fshatrat e bukura lidhur me njëri-tjetrin, dukej si një gjerdan i rrallë në gushë të maleve. Por në këtë orë të afërmesnatës, as që mund të bëhej fjalë për bukuritë natyrore, prandaj krahasimi që bëri kryehetuesi ishte më i papërshtatshmi. Kur makina hyri në fshatin e parë, qentë e zgjidhur iu lëshuan si të tërbuar.

-Na ndjejnë në erë që nuk jemi nga kjo anë, -tha polici shoqërues.

-Jo, -tha shoferi.- nuk janë mësuar me makina.

-Lëshohen si ujk, -tha kryehetuesi.

"Dhe njerëzit, kështu janë, -mendoi kryetari, -por do ta shohim nesër."

Zbatimi i planit të përgatitur me kujdes nga qendra, edhe me tre kryetarët e rretheve fqinjë, godiste shumë nga karakteret kryeneçe të zonës. Dhe një goditje e tillë në fund të viteve gjashtëdhjetë ishte "Hapu varr të futem". Kryetari qeshi me vete e u mbështet fort në ndenjëse i kënaqur nga besimi që kishte patur qendra për ta vënë drejtues të planit.

"Pas kësaj, -mendoi, -ka karrierë, ka tiranë. Ah, Tirana".

Ndërkaq shoferi ndaloi makinën se një gur ishte rrokullisur e kishte qëndruar në mes të xhades.

-Ta heqim, -tha ai.

Polici hoqi siguresën e automatikut dhe hapi ngadalë derën. Kryetari dhe hetuesi vunë duart në pistoletat. Polici zbriti hoqi gurin dhe hipi prapë në makinë. Kur u nisën, ata hoqën duart nga pistoletat dhe morën prapë qëndrim zyrtar. Nuk folën derisa arritën në qendër të fshatit Gjokaj.

Aty, para se të errej, plotfuqishmi i zonës hyri në dhomën e telefonit të fshatit Gjokaj dhe u lidh me fshatin tjetër ku ishte postëkomanda, e pasi kërkoi postëkomandantin, i tha:

-Nisuni, -dhe mbylli telefonin.

U drejtua për nga klubi. Në atë orë lokali vogël popullohej pak ose hiç fare. Pihej shumë raki në atë fshat edhe pse prodhohej pak ose hiç fare. Vendi ishte shumë lart mbi nivelin e detit dhe rrushi donte hyzmet që të rritej, ndaj banorët mbillnin më shumë bimë që i përshtateshin klimës si gështenjë, mollë, ftonj, arrë përveç lajthisë, sepse ato ishin me shumicë nga natyre, aq sa një pllajë mali i tërë quhej Lajthizë, sepse ishte një pyll lajthie i vërtetë me burime me ujë të ftohtë e të lehtë. Aq shumë lajthi kishte sa kur piqeshin, vinin fshatçe për t'i mbledhur. Dhe ai bllok i madh natyror për çudi nuk ishte shtetëzuar. Fëmijë, plaka e gra futeshin pyllit e mbushnin trastat. E kur vine miku, pjata me lajthi ishte nga të parat e qerasjeve që bëhej.

“ E kuptoj që ndërpres herë pas here rrjedhën e tregimit, por kam lindur në atë krahinë dhe kujtimet që kam e malli që më djeg për të, ma tërheqin penën sa herë që u del fjala në shteg”

I plotfuqishmi u drejtua te banaku, i tha një djali të gjente sekretarin e partisë dhe mori një gotë raki.

Sekretari erdhi pas pak, u përshëndetën, mori dhe ai një gotë raki, e trokiti me të plotfuqishmin dhe po i pinin ngadalë, secili në mendimet e veta.

“ Tani nisat nga qyteti shoku Zajdin”, -mendoi i plotfuqishmi duke parë orën.

“Përse më desh”, -mendoi sekretari duke thithur gotën.

Sekretari ishte djalë nga ai fshat. I përkiste brezit, që në kohën e luftës ishin fëmijë. Kishte mbaruar shkollën shtatëvjeçare dhe si shumica e burrave të fshatit, ishte bërë blegtor. Pasi kishte kryer shërbimin ushtarak në kufi, ishte kthyer në fshat. Kur u pranua në parti, ishte një djalë, që dallonte nga të tjerët dhe dajua i tij, kryetar kooperative në atë kohë, e dërgoi në një kurs për veteriner. Që atëherë, ai punonte në atë detyrë, jo vetëm për fshatin e tij, por për gjithë zonën. Ishte i zgjuar nga natyra dhe e ndjeu se ftesa që iu bë, ishte për një “Dasmë të madhe”.

-Do të marrim dhe nga një?

-Jo, jo, -I tha ai.-Do vemi në zyrë.

Sekretari pagoi dhe dolën.

Ndërsa ku ishte zyra e partisë, siç i thoshnin, ndërtesa dykatëshe e vjetër në qendër të fshatit, ish pronë e një fisi në gjendje të mirë ekonomike në kohën e parë. Aty ishin mbledhur, në katin e dytë, të gjithë zyrat e kooperativës së vogël.

Në katin e parë ishin infirmjaria, posta e diçka tjetër. Përballë ndërtesës ishte tyrbeja, që nuk kishte shumë kohë që ishte braktisur si pasojë katrahurës antifetare, që ishte zhvilluar para pak kohësh. Nuk ishin shumë fetarë banorët e zonës, por nuk e ngisnin Zotin në shtëpinë e tij. Kishin parimin, që ai është atje lart, na sheh, na dëgjon e na gjykon. Për shërbëtorët e tij në tokë nuk kishin shumë nderim, se ashtu ishin mësuar.

-Le t'i dërgojë Zoti të mirë, -thoshnin, -jo si filanin e filanin, që talle fëmija me ta. Dhe banorët tani nuk e kthenin kokën nga tyrbeja por këtej, nga ndërtesa dykatëshe, ku ishte tyrbeja e fesë së re shqiptare, zyra e partisë.

Sekretari hapi zyrën, ndezi dritën, në mund të quhej dritë, hynë brenda dhe u ul në karrigen e vjetër. I plotfuqishmi, u ul në cep të tavolinës, me njërin këmbë në tokë e tjetrën varur.

-Ku është muharrebeja?-pyeti sekretari

-Në gjokaj, -tha I plotfuqishmi.

Sekretari priti që ai të fliste më shumë, por i plotfuqishmi heshti .Ai mendoi lidhjet e tij me Gjokajt, dhe, kur pa që veç një kushërire të largët, ishte martuar atje, nuk kishte lidhje tjetër, u qetësua.

-Po çfarë?-tha pas pak.

-E di shoku Zajdin, -mori përgjigje.-Është nisur për këtu.

-Si është nisur?-tha, - Ç' do bëjmë?

-Nuk ka kohë për gjë, -I tha tjetri.-Ai vjen natën për punë dhe do iki prapë natën.

-Ti e di, -i tha sekretari, -por mos na turpëro po deshe.

Shokun Zajdin, ai e kishte parë gjithë-gjithë dy herë. Herën e parë në festën e çlirimit të krahinës, dhe një herë tjetër në një mbledhje të plenumit të partisë në rreth, ku ai ishte anëtari i byrosë dhe kishte folur për gjallërimin e armikut të klasës dhe për grushtin e fortë që do t'i jepte diktatura e proletariatit.

“Ehe, -tha me vete, -grushti. Shyqyr që qënka larg nga unë”, -dhe iu kujtua barsoleta e priftit kur u dogj fshati..Ndërkaq, i plotfuqishmi shikonte nga dritarja në atë drejtim të horizontit nga vinte rruga nga qyteti, afërsisht sa i lejonte nata, në grykë të borës. Kur dritat e makinës vezulluan atje, ai tha.

-Tani dolën në grykë të borës, për një orë janë këtu. Sekretari u ngrit, doli jashtë dhe dërgoi rojen në klub të merrte një kile raki dhe nja pesë gjashtë gota. Priti rojen sa të vinte, se klubi ishte pothuajse ngjitur me zyrat, mori porosinë dhe u ngjit prapë lart. Kur dritat u shfaqën si xixëllonja në grykë të borës, postëkomandanti dhe dy policë, që e shoqëronin, ishin atje ku kthehet rruga për në Qafë të kalit, që e lidh zonën me Bregdetin. Sepse i ka mbetur emri Qafa e kalit nuk e di, por një toponim si gjithë të tjerët, herë me kuptim të vërtetë, e herë se ashtu e ka quajtur i pari, pa kuptim fare. Që andej fshati Gjokaj, nuk është më shumë se dhjetë minuta më këmbë.

-Po ajo makinë ç'do të jetë?-tha njëri nga policët që shoqëronte postëkomandantin.

-Bëri xhadenë partia, -tha postëkomandanti.-Taksi mund të jetë, ambulancë apo makinë qeverie. U bë krahina qytet tani. Në kohën e duhur postëkomandanti dhe policët ishin te ndërtesa dykatëshe. Policët u ulën në sofate, në hyrje, ndërsa postëkomandanti u ngjit lart, në zyrën e partisë. Gjithë këto lëvizje, atë dark. Plotfuqishmi në darkë në fshat, takimi me sekretarin e partisë, vajtja në zyrën e tij, rakia që bleu roja, drita e makinës në Grykë të borës e policët nga lokaliteti, nuk mbetën pa rënë në sy të banorëve. Por ata ishin mësuar me to dhe donin të ishin sa më larg tyre. Kushedi sa herë e kishin pësuar për një bejte në dasma... Sa ata janë të gjithë bejtexhinj dhe po hyre në bejtet e tyre do një jetë të nxjerrësh kunjat, ndaj e mblodhën mendjen, “që të qasen më shpejt në nome” se herët e tjera, siç thonë ata, dhe të prisnin kujt do t'i trokiste porta...Makina ndaloi përpara godinës dhe i plotfuqishmi e sekretari u dhanë dorën të ardhurve.

Shoku Zajdin, kryehetua

esi, sekretari dhe i plotfuqishmi u ngjitën prapë lart. Polici shoqërues u bashkua, me të tjerët, kurse shoferi, i lodhur, mbështeti kokën mbi timon të bënte një copë herë gjumë. Sa u ngjitën lart ata të katër, fjalën e mori shoku Zajdin.

-Puna e partisë në fshat, -tha ai, -ka rënë shumë, dhe jo vetëm këtu, por në të gjithë zonën. Partia është e pakënaqur nga organizatat, por këtë do ta gjykojë byroja dhe plenumi. Ne kemi ardhur të bëjmë detyrën tonë si organe të diktaturës.

Sekretari e vështronte në sy dhe ishte bërë meit. Djersë të ftohta ia mbuluan trupin. Ai e dinte mirë kur diskutoheshe për zbutje të luftës së klasave, por nuk i vaji mendja që kishte dhe më keq.

-Sonte, -vazhdoi kryetari, -do të arrestojmë Begë Gjokën, se i vëllai i tij, ai mësuesi, që partia i ka bërë aq ndere, u kap në kufi për tentativë arratisjeje, kurse vetë Bega, veç bashkëpunimit me të ka edhe shumë probleme të vjetra, këtu e njëzet-vjeçare. Qeni i mutit, thëngjilli i mbuluar, strehuesi i diversantëve, agjenti i vjetër, kujtoi se do t'i shpëtonte syrit vigjilent të popullit. Me lëkur do ta paguajë, qeni, -përfundoi ligjëratën shoku Zajdin.

-Ti, -iu drejtua pastaj të plotfuqishmit, -bëj detyrën,

-Urdhërin e arrestit të prokurorit e kam unë, -tha kryehetuesi.

Të gjithë u larguan të bënë detyrën. Në zyrë mbetën kryetari e sekretari, ndërsa te porta, polici shoqërues dhe roja i tromaksur i zyrave.

Arrestimi u krye rrufe dhe të gjithë të ardhurit u larguan.

Sekretari në zyrë nuk kishte mbledhur veten akoma. Ç'ta mblidhte. Ajo që pa e dëgjoi, ishte si një vetëtimë behari në qiell të kulluar. Mbështeti kokën mbi dy duart në tavolinë dhe ndenji ashtu një copë herë të gjatë. Pastaj iu kujtua rakia.

Hapi dollapin, mori shishen e i mbushi të dy gotat plot, hapi dritaren e i foli rojes të ngjite lart, e , kur ai u ul, pa i ikur akoma të dridhurat e tromarës, e ktheu me fund gotën e parë.

Klubxhiu i fshatit, kur hapi lokalin në orën pesë të mëngjesit, u habit kur i gjeti te dera

-Këtu jeni dirë?- i pyeti ai në dialektin vendas.

-Dy kafe shqeto, -i tha sekretari.

-Plasja u preftë!-u tha ai.-Ku jeni rregulluar kështu, si i bukuri shejtan?

Lajmi i arrestimit të mësuesit David Gjoka, për tentativë arratisjeje, u hap si vetëtimë në qytetin e vogël. Në qytet at e njihnin të gjithë, se kishte punuar disa vjet, dhe jo vetëm atje, por edhe në disa fshatra të rrethit.

Ca e besonin, ca nuk e besonin. Ca habiteshin e ngrinin supet, ca e bluanin brenda e tymosnin cigare. Po ajo kishte ndodhur dhe mësuesi me të vëllamë, ishin tani në duart e sigurimit të shtetit, që e bënte natën ditë për të mbrojtur fitoret e arritura.

Lutoja, një ish intelektual i vjetër, që si gjithë të tjerët e njihje mësuesin, kur e dëgjoi sa kishte qenë vetë pre e tyre . Kishte mbaruar një shkollë në kohën e Zogut. Dhe atëherë kishte bërë burg nga Zogu edhe pas luftës kishte bërë burg nga partia. Dhe pse? Sepse kishte bërë shaka me një shok në italisht. Akuza ishte rregulluar aq mirë e aq hollë, sa i ziu Luto e pagoi shakanë me dhjetë vjet burg për agjitacion e propagandë.

Kur doli nga burgu, Lutoja kishte harruar, jo më italishten, por edhe shqipen e fliste vetëm me veten e tij. Ai i njihje mirë ligjet dhe nenet për të cilat akuzohej mësuesi, që të paktën i kishin njëzet e pesë vjet burg.

“I shkreti djalë, -tha me vete, se me të tjerët ai nuk fliste.-E mbylli jetën”.

Më e hidhur nuk i ishte dukur ndonjë herë kafeja. Shkolla atë ditë e nisi jetën ndryshe nga herët e tjera. Nxënësit bisedonin me zë të ulët me njëri-tjetrin.

-E dëgjove?-njëri

-E dëgjova, -tha tjetri.

-E vërtetë?, -njëri.

-E vërtetë, - tjetri.

-Si kështu?-njëri.

_Nuk e di, - tjetri

Diçka foli drejtori i shkollës dhe nxënësit u futën nëpër klasa. Që atë ditë e më pas, deri në daljen e mësuesit në gjyq, organizatat e rinisë, të pionierit e deri të foshnjave në kopshte, flisnin për rritjen e vigjilencës revolucionare, për sytë hapur ditë e natë, sepse armiku i klasës , kishte penetruar deri atje ku edukohej brezi i ri, ai brez, që do ta ngjiste socializmin në majat më të larta . Dhe ai brez, ende pa e dorëzuar partia stafetën, doli në rrugë e në shesh, vite më vonë, dhe e dërgoi socializmin andej nga kishte ardhur.

David Gjoka, lindur pikërisht në atë krahinë të bukur malore, të cilën u mundova ta përshkruaj në fillim të tregimit. Si gjithë fëmijët e tjerë u rrit me varfëri e skamje, por në shkollë mësonte shumë. Ashtu , pa ndjerë, u madhua, mbaroi shkollën për mësues dhe e emëruan në fshat. Serioz e kërkues, me horizont të gjerë kulturor, i dashur e i gjendur, cilësi këto, që e prunë në qytet e që më vonë do ngjallnin smirën e inatin për t’i ngrënë kokën .Atëherë ose do të kishe miq të fortë e biografi të mirë të vije në qytet, ose duhej të shkëlqejë. Dhe Davidi vërtet shkëlqente. Kush ka qenë nxënës i tij dhe i bie në dorë ky tregim, kam bindjen se përveç këtyre që shkruaj unë, do të radhiste dhe shumë cilësi të tjera, se i tillë ishte. Dhe ishte i bukur mësuesi. Flokët e zinj, që i bënin mbi ballin e mençur, sytë e shkruar dhe trupi si lis e dallonin nga të tjerët. Nuk ishte i martuar. Kishte dhe ai një dashuri, që u dogj në heshtje brenda gjirit, ndërsa u “martua” me burgun.

Kohën e hetuesisë dhe të burgut nuk do t’i përshkruaj sepse ato janë disa libra më vete, dhe se kam besimin që mësuesi, si njeri i letrave që është, do të shkruajë vetë për to, për të derdhur atje jetën e tij plot dhimbje, por edhe shpresë.

Gjyqi i tij ishte një”spektakël”masiv i drejtuar nga “regjizorë” mjeshtra për aktivitete të tilla.

Afishet për gjyqin e hapur të “armikut” të rrezikshëm, David Gjoka, mbushën qytetin. Askush nuk punonte, askush nuk vinte në shkollë atë ditë. Rruga, nga Dega e brendshme e deri në shtëpinë e kulturës, ku do të zhvillohej gjyqi, ishte mbushur në të dy anët me njerëz sa nuk kishe ku të hidhje kokrën e mollës. Policë të shumtë qarkullonin për të shmangur ndonjë të papritur .

Në orën e caktuar, atë e nxorën nga qelia duarlidhur dhe ashtu, i shoqëruar me roje të shumtë, bëri”paradën e turpër, siç e quajti njëri nga vëzhguesit. Njerëzit bërtisnin, çireshin, shanin. Qyteti tronditej nga gjithë ajo zamallahi: ai ecte i qetë duarlidhur. Nga bukuria e tij nuk kishte mbetur gjë. Vetëm sytë ruanin fizionominë e tyre. Diku një nxënëse e tij, u shkëput nga radhët e popullit dhe duke bërtitur iu afrua dhe e pështyu në fytyrë. Ai qëndroi ca, aq sa e lanë, hodhi sytë e bukur mbi nxënësen, buzëqeshi pak, ngriti duart e lidhura dhe fshiu fytyrën. Ata, që e kishin dërguar e hoqën shpejt nxënësen dhe e futën në sallën e gjyqit.

Vetëm ai, intelektual, që e kishte paguar me një dhjetëvjeçar, e ndiqte spektaklin nga larg. Iu drodh buza, iu rrënoqeth mishi nga gjithë ato që vështronte. Me duar të dridhura mezi nxori paketën nga xhepi, mori cigare dhe e vuri në buzë, e ndezi dhe e thithi thellë-thellë sa i mbushi mushkrihtë plot me tym. Lidhi duart nga prapa dhe u largua për të mos parë e dëgjuar më gjë.

“ I shkreti djalë”, -tha për herë të parë pas kaq kohësh....Askush nuk e dëgjoi, se njerëzit ishin atje, në spektaklin e regjisorëve të mëdhenj, atje ku vihej në gijotinë koka e mençur e mësuesit. Të gjithë njerëzit, nuk i merrte salla e gjyqit. Brenda hynë vetëm ata që kishin ftesa, ndërsa për të tjerët, që mbushën lulishte përpara shtëpisë së kulturës, organizatorët kishin vendosur altoparlante, që të mos shpëtonte asgjë pa dëgjuar, nga mileti.

Kur e mori fjalën prokurori për të bërë aktakuzën, qytetin e mbuloi heshtja. Një akuzë e gjatë, e përgatitur me kujdes, e ngarkuar rëndë, që hëngri disa orë sa të mbaronte. Prokurori, që kushedi sa prova kishte bërë për atë ditë, dukej sikur recitonte. E gjithë qënia e tij ishte përqendruar aty.

Dhe mileti mendonte:

“Sa i fshehur paska qenë, sa shumë krime ka bërë, po ky e paska filluar veprimtarin kriminele që në djep. Shyqyr, na shpëtoi partia. Na shpëtoi shoku Zajdin. Sa i përgatitur është shoku Zajdin. E se mos vetëm ai, të tërë ashtu i ka partia, astritë me pika.

Mësuesi nuk e mohoi tentativën për arratisje në fjalinë e tij.

-Desha të arratisem nga një burg, -tha ai.- Ky vendi ynë u bë si një burg i madh, burg masiv, burg, që mban brenda gjithë popullin e tij.

-Pusho!- ulëriti prokurori, -dhe qeskat e syve iu varën më poshtë si dy trasta të mbushura me rërë.-Tradhëtar, gjarpër!

-Po-tha mësuesi, -më mirë gjarpër se sa krimb si ti, o i mjerë.

-Të varet ! të varet, krimineli !-bërtisnin ata, që ishin brenda sallës me ftesa.

Dëshmitarët, një lukuni e tërë, nga brenda e nga jashtë vendit, thanë”fakte” të reja për akuzën.

“Interesante” ishte dëshmia e një mësuesi nga jashtë vendit, i cili me gjysmë shqipërishten e tij tha:

-Në një mbrëmje të shtatë marsit, i pandehuri ka thënë: Rroftë udhëheqësi ynë sa malet e Greqisë!

-Po për këtë ç’do të thuash?-i tha kryetari i trupit gjykues.

-Nuk e di ta kem thënë, -tha mësuesi, -por dhe në e kam thënë, malet njëlloj janë në të gjithë globin.

-Ashtu?-i tha kryetari.-si malet tanë janë?Si këta male, që kanë mbajtur luftëtarët e lirisë, që kanë thyer hundët armiqtë në ta? Dhe malet arrin e shan, mor tradhtar?!

Vetëm njëherë iu drodh buza mësuesit, kur futën në sallën e gjyqit të vëllanë, Begën. Ai nuk e dinte që e kishin arrestuar edhe atë. E donte shumë Begën: ai pothuajse e kishte rritur . Dhe për atë akuza ishte e rëndë. Bashkëpunim me bandat diversioniste, agjitacion e propagandë kundër pushtetit popullor, e të tjera të stisura në makinën makabre të hetuesisë.

Shtrengoi dhëmbët kaptoi lotin dhe të gjitha dhe të gjitha akuzat që i bëheshin vëllait i mori për vete, edhe pse e dinte që nuk e lehtësonte aspak.

Gjatë të gjithë përgjigjeve që dha paskëtaj, sytë i mbante tek ai, vëllai i dhembshur, që kushedi si do t'i shtynte vitet e shumtë të burgut.

Gjyqi zgjati disa ditë. Atë ditë që do jepej vendimi "Në emër të popullit", kërshëria e miletit shfaqej hapur.

Dhe ai u dha.

Mësuesi u dënua me njëzet vjet heqje lirie, duke i hequr dhe të gjithë dekoratat, që i kishte dhënë partia dhe pushteti popullor.

Vëllai i tij, Begë Gjoka, u dënua me njëzet vjet heqje lirie.

Vite më vonë, kur në vendin tonë kishte fituar demokracia, e pashë nga afër mësuesin tim. Ishte plakur, por ndënë mustaqe, buzëqeshja nuk i kishte ndryshuar dhe sytë e shkruar vështroin si dikur me ëmbëlsi.

Atë ditë m'u kujtuan të gjitha këto dhe i hodha në letër.